



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE
KOLEGJI DOKTORAL

PROCEDURA E KONKURIMIT

Konkurimi do të kalojë nëpër tri faza

• **FAZA 1**

VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM

Këtu vlerësohen kualifikimet dhe dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatët.

Pikët maksimale janë 50, të ndarë si më poshtë:

- nota mesatare mbi 8 (10 pikë)
- Projekti kërkimor i paraqitur (20 pikë)
- publikime të mëparshme (10 pikë)
- vlerësimi i përmbledhjes së temës së masterit (5 pikë)
- eksperiencë në mësimdhënie (5 pikë)

Brenda datës **15.05.2026** në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, afishohet lista e studentëve fitues për këtë fazë.

• **FAZA 2**

PROVIMI ME SHKRIM

Pikët maksimale janë 25.

Testi kalohet me minimumi 10 pikë. Testi konsiston në zhvillimin me shkrim të një tematike të caktuar nga Kolegji Doktorat. Temat publikohen bashkë me shpalljen e konkurrimit.

Provimi me shkrim, do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në datë **18.05.2026**, ora 10.00-12.00, salla 202 godina C (Telemedicina).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE
KOLEGJI DOKTORAL**

- **FAZA 3
PROVIMI ME GOJË**

Pikët maksimale janë 25.

Provimi me gojë konsiston në një prezantim të detajuar të projektit të kërkimit, të prezantuar nga kandidati si edhe certifikimin e njohurive në gjuhë të huaj. Provimi me gojë do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në datë **25.05.2026**, ora 10.00-14.00, salla 202 godina C (Telemedicina).

*Pas përfundimit të tri fazave, Kolegji Doktorale, shpall brenda datës **29.05.26** listën e me renditjen e plotë të aplikantëve sipas pikëzimit. Kandidatët që kanë marrë me shumë pikë, kualifikohen (sipas kuotave të miratuara, 5 (pesë kandidatë). Aplikanti mund të njihet mbi vlerësimin e tij, nëpërmejt kërkesës drejtuar Kolegjit Doktorale, mbi vlerësimin e aplikimit të tij. Aplikanti merr përgjigje me shkrim, brenda 10 ditëve nga momenti i depozitimit të kërkesës.*